


Tregtia e jashtme e mallrave

Janar 2018

Tiranë, më 19 Shkurt 2018: Në Janar 2018 eksportet e mallrave arritën vlerën 23 mld lekë, duke u rritur me 23,6 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe 6,4 %, në krahasim me Dhjetor 2017. Importet e mallrave në Janar 2018 arritën vlerën 45 mld lekë, duke u rritur me 27,0 %, në krahasim me një vit më parë dhe u duke u ulur me 26,5 %, në krahasim me Dhjetor 2017. Deficiti tregtar i këtij muaji është 21,3 mld lekë, duke u rritur me 31,1 %, krahasuar me Janar 2017 dhe duke u ulur me 45,1 %, në krahasim me Dhjetor 2017.


Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)



Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Rritja vjetore e eksporteve prej 23,6 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: "Materiale ndërtimi dhe metale" me +10,5 pikë përqindje, "Tekstile dhe këpucë" me +8,1 pikë përqindje, "Ushqim, pije, duhan" me +2,7 pikë përqindje. Grupi që ka ndikuar negativisht në ndryshimin vjetor të eksporteve, është: "Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike" me -1,9 pikë përqindje.


Fig.2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Janar 2018



Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Rritja vjetore e importeve prej 27,0 %, këtë muaj është ndikuar kryesisht nga grupet: “Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike” me +10,9 pikë përqindje, “Makineri, pajisje, pjesë këmbimi” me +5,6 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +3,3 pikë përqindje. Në ndryshimin vjetor të importeve nuk ka ndikuar negativisht asnjë grup.

Fig.3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Janar 2018




Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere

Në muajin Janar 2018, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Janar 2017 janë: Italia me (6,1 %), Spanja me (114,6 %) dhe Kosova me (43,7 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur uljen më të madhe janë: Franca me (-15,4 %), Rumania me (-6,8 %) dhe Hungaria me (-18,7 %).

Në muajin Janar 2018, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritje më të madhe të importeve, në krahasim me Janar 2017 janë: Italia me (14,9 %), Turqia me (40,2 %) dhe Kina me (12,9 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe janë: Shtetet e Bashkuara me (-11,9 %), Rusia me (-30,8 %) Egjypti me (-7,5 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Janar 2018



Në Janar 2018, shkëmbimet tregtare me vendet e BE zënë 67,1 %, të gjithë tregtisë. Eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 81,5 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 59,5 % të importeve gjithsej. Partnerët kryesorë tregtarë janë: Italia (35,6 %), Greqia (7,2 %), Kina (6,7 %) dhe Gjermania (6,2 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave

Vitet	Muajt	Eksporte (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Importe (mld lekë)	Ndryshimi Vjetor (%)	Bilanci Tregtar (mld lekë)	Mbulimi (%)
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626	8,1	-353	43,6
2015	01 - 15	18	-0,6	35	0,9	-17	50,4
2016	01 - 16	16	-7,8	35	-1,0	-19	47,0
2017	01 - 17	19	15,6	35	0,9	-16	53,8
2018	01 - 18	23	23,6	45	27,0	-21	52,3

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë)

	Eksporte		Importe	
	Janar 2017	Janar 2018	Janar 2017	Janar 2017
Vendet e BE-së	15.763	19.060	20.800	26.598
Austri	86	176	269	367
Mbretëri e Bashkuar	38	42	314	350
Gjermani	735	1.227	2.484	3.002
Greqi	735	1.192	2.593	3.677
Itali	11.743	12.464	10.223	11.749
Spanjë	879	1.887	598	945
Kroaci	41	55	258	415
Të tjera të BE-së	1.505	2.018	4.062	6.093
Kinë	601	724	3.386	3.822
Kosovë	941	1.353	351	409
Maqedonia	278	491	342	476
Rusi	-	0	907	628
SHBA	149	457	852	751
Turqi	107	104	2.750	3.855
Ukrainë	80	-	289	73
Zvicër	75	105	436	1.772
Të tjera	935	1.096	5.074	6.318
Gjithsej	18.929	23.390	35.186	44.702

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë)

Grup-mallrat	Eksporte		Importe	
	Janar 2017	Janar 2018	Janar 2017	Janar 2018
Gjithsej	18.929	23.390	35.186	44.702
Ushqime, pije, duhan	1.270	1.781	6.818	7.339
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	3.922	3.564	3.392	7.211
Produkte kimike dhe plastike	245	325	5.441	5.818
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	177	256	1.097	1.191
Prodhime druri dhe letre	569	705	1.063	1.631
Tekstile dhe këpucë	9.021	10.554	5.403	6.236
Materiale ndërtimi dhe metale	2.372	4.351	3.638	4.787
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	880	1.222	7.028	9.005
Të tjera	473	632	1.307	1.485

Tab. 4 Eksportet sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë, Janar 2017-2018 (milionë lekë)

	Itali		Spanjë		Kosovë		Gjermani	
	2017	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018
Gjithsej	11.743	12.464	879	1.887	941	1.353	735	1.227
Ushqim, pije duhan	463	619	56	82	111	109	100	117
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	1.735	413	641	1.492	440	80	148	153
Produkte kimike dhe plastike	87	123	0	6	60	49	0	6
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	153	209	1	9	-	-	0	0
Prodhime druri dhe letre	444	516	1	281	17	32	12	7
Tekstile dhe këpucë	7.020	8.073	172	16	8	12	422	734
Materiale ndërtimi dhe metale	1.056	1.330	7	0	201	965	4	80
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	553	798	-	0	27	39	34	91
Të tjera	232	382	0	-	78	67	15	40

Tab. 5 Importet sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë, Janar 2017-2018 (milionë lekë)

	Itali		Turqi		Kinë		Greqi	
	2017	2018	2017	2018	2017	2018	2017	2018
Gjithsej	10.223	11.749	2.750	3.855	3.386	3.822	2.593	3.677
Ushqim, pije duhan	1.061	1.284	376	387	58	66	789	1.017
Minerale, lëndë djegëse, energji elektrike	1.029	1.278	130	43	1	0	453	804
Produkte kimike dhe plastike	1.053	975	438	543	392	448	359	444
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	899	925	21	16	41	64	1	2
Prodhime druri dhe letre	347	492	40	217	88	107	148	199
Tekstile dhe këpucë	2.785	3.115	942	1.159	755	772	225	282
Materiale ndërtimi dhe metale	1.048	1.225	404	808	459	558	398	668
Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi	1.706	2.100	296	481	1.248	1.465	90	156
Të tjera	293	354	103	200	343	342	131	104

Përkufizime

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv, ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit, edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Mbretëria e Bashkuar, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Revizionime mujore

Të dhënat që bëhen të disponueshme për muajin e fundit kanë efekt edhe në revizionimin e muajve paraardhës, sepse me ardhjen e të dhënave për muajin e fundit vijnë edhe të dhënat e përditësuara për muajt e mëparshëm si rezultat i përditësimeve të burimit administrativ.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri